

## THEMELOHET INSTITUTI ZVICERAN I STUDIMEVE SHQIPTARE

**Ky institut me emërtimin ISEAL, me seli në Lozanë, drejtor dhe ideator të cilit është intelektual i ri Driton Kajtazi, tubon rreth vetes personalitete të shquara zvicerane e shqiptare. - Qëllimin themelor e ka zhvillimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, duke ndihmuar integrimin e shqiptarëve në Zvicër, si një nga komunitetet më të mëdha nga radhët e të huajve në këtë vend.**

Në Zvicër tashmë është formuar Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare (ISEAL), cili qëllim kryesor ka zhvillimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet Zvicrës dhe shqiptarëve, që të ndihmojë integrimin e shqiptarëve në Zvicër dhe që të bëhet një partner i njohur prej autoriteteve të Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, për të gjitha çështjet në lidhje me komunitetin shqiptar të Zvicrës, si dhe që ky institut të shërbejë si pikë referimi për vende të tjera ose organizata ndërkombëtare që interesohen për çështjet shqiptare. Ngase siç vlerësohet në Zvicër jetojnë një komunitet tejet i madh shqiptarëve dhe se ata përbëjnë komunitetin e dytë pas italianëve. Konstatohet gjithashtu se në Zvicër, institucione dhe shoqata të shumta tregojnë interesim për komunitetin shqiptar në një formë apo tjetër. Mirëpo, asnjëra prej tyre, nuk e studion dhe nuk pasqyrojnë komunitetin shqiptar në tërësi, ndaj edhe siç mësojmë nga drejtori i këtij Instituti, z. Driton Kajtazi, kjo edhe ishte arsyeja që me emrin *Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare* (ISEAL-i), të formohet një fondacion, në bazë të neneve 80 e në vazhdim të Kodit Civil Zviceran. Nisma për këtë ndërmarrje serloze është kurorëzuar i punës disa vjeçare, për çka edhe flet fakti se statutet e ISEAL-it janë miratuar zyrtarisht nga anëtarët themelues qysh më 8 dhjetor 2007 në Lozanë dhe janë pranuar nga autoritetet federale më 25 mars 2008. **ISEAL është njohur nga konfederata Zvicerane si Institut me Vlerë Publike.**

Sella e ISEAL-it është në Lozanë derisa aktivitetet e saja do të zhvillohen në tërësinë e territorit helvetik dhe më gjerë. ISEAL tashmë ka marrë kontakte premtuese me partnerë të numërt institucionesh dhe shoqata si në Zvicër ashtu edhe në Shqipëri dhe Kosovë.

Për t'i arritur qëllimet e tij, ISEAL-i, do të shfrytëzojë një Institut Shkencor

me 4 sektorët e mëposhtëm:

- **Kërkime:** Të bëjë kërkime në fusha të ndryshme si: formimi, integrimi, politika, gjuhësia, sociologjia, ekonomia, kultura, historia, gjeografia dhe teologjia.
- **Botime:** Të botojë vepra periodike, libra, broshura dhe buletine të tjera (në gjermanisht, frëngjisht, italisht, shqip etj.).
- **Mësimdhënie:** Të japë një mësimdhënie e cila do të përfundojë me formime të vërtetuara dhe/ose me kredit ECTS (*European Credit Transfer and Accumulation System*).
- **Qendër dokumentimi:** Në bashkëpunim me universitetet, shkollat e larta, bibliotekat dhe autoritetet e Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë si dhe me institute të ndryshme private apo publike.

Ndërsa fillimi i aktiviteteve nis nga muaji nëntor 2010, ku një ekip i vogël, i shoqëruar nga afër nga Këshilli i Fondacionit ISEAL, do të vë në veprim vëllën e strukturave të ISEAL-it. Anëtarë themelues të këtij Instituti janë:

Barbara BURRI-SHARANI, psikologe, Magaly HANSELMANN, koordinatore e Kantonit Vaud në fushën e integritit të të huajve dhe parandalimit të racizmit, Prof. Dr. Doris JAKUBEC, ish drejtoreshë e Qendrës së Kërkimeve Letrare të Zvicrës Françeze, Daniel ABIMI, gazetar, Francis COUSIN, ish ambasador, Driton KAJTAZI, autor dhe mësimdhënës, Prof. Dr. Peter KNOEPFEL, Profesor titullar i katedrës së politikave publike, afatgjate e zhvillimore pranë IDHEAP-it, Dr. Régis MARION-VEYRON, mjek-psikiatër, M. Bruno MIGLIARINI, kuadër bankar, Victor RUFFY, gjeograf, ish kryetar i Parlamentit Zviceran dhe

Prof. Dr. Basil SCHADER, profesor në SHLP në Cyrih.

Nga biseda që patëm me z. Driton Kajtazi, Drejtor i ISEAL-it, mësojmë se nga projektet e Institutit ISEAL në të ardhmën janë:

«INTEGRIMI I SHOQIPTARËVE NË ZVICËR, me një qasje të kryqëzuar me komunitete të tjera»: Simpozium shkencor në IDHEAP (*Instituti i Studimeve të Larta për Administratë Publike*), në bashkëpunim me Universitetin e Lozanës.

«SHQIPTARËT E ZVICRËS»: Një kërkim i thellë me një ekip, i shoqëruar me një botim të ilustruar, të botuar në gjuhën gjermane, frëngje, italiane dhe shqipe.

«ANTOLOGJI E LETËRSISË SHQIPTARË»: Botim në gjuhën gjermane, frëngje dhe italiane (vështrim historik, paraqitje e autorëve, tekste të zgjedhura, dokumente dhe komente).

«ANTOLOGJI E LETËRSISË ZVICERANË»: Botim në gjuhën shqipe (vështrim historik, paraqitje e autorëve, tekste të zgjedhura, dokumente dhe komente).

«ARTI made in Kosovo...»: Ekspozita në Zvicër të artistëve dhe të artit kosovar.

«NJË EKONOMI APO VETËM KURSIME?»: Forum ekonomik.

«NJË E ARDHME FEMËRORE»: Studim për femrën shqiptare në Zvicër.

«SI JENI ME SHËNDET?»: Kërkim mbi shëndetin publik.

«FJALA PAMJEVE»: Paraqitje e kinematografisë në gjuhën shqipe.

Në kuadër të Institutit Zviceran i Studimeve Shqiptare tashmë vepron edhe shoqata e miqve të këtij instituti: ISEAL me mbi anëtarë 132 themelues, personalitete shqiptare, zvicerane dhe të tjerë.

Shoqata e miqve të ISEAL-it drejtohet aktualisht nga Komiteti i përbërë nga Visar QUSA, kryetar, Arsim FERIZI, anëtar, Jean RUFENER, anëtar, Znj. Lucy CLAVEL RAEMY, anëtare, Ing Mentor ILAZI, anëtar.

Shoqata ISEAL e ka edhe një Komitet nderi me 12 anëtarë:

Prof. Dr. Antonio DA CUNHA, Prof. Astrit LEKA, Znj. Barbara HAERING, Dr. Christian ZINDEL, Z. Georges CUENOT, Znj. Katherina WASHINGTON, Shkël. e tij, Z. Mehmet ELEZI, Z. Rolf ALTHERR, Z. Ueli LEUBENBERGER, Z. Xhemali BERISHA dhe Artistja e madhe Vaçe ZELA.

Më 24 prill 2010 në Bernë në Restorantin RIALTO, pronë e një shqiptari, u mbajt edhe një eveniment kulturor, i organizuar nga shoqata ku morën pjesë personalitete të shquara të shoqërisë zvicerane, si



DRITON KAJTAZI, DREJTOR I ISEAL-IT.

z. Francis COUSIN, ish ambasador i Zvicrës në Shqipëri, Victor RUFFY, gjeograf, ish kryetar i Parlamentit Zviceran, Prof. Dr. Basil SCHADER, profesor në SHLP në Cyrih, ndërsa nga radhët e shqiptarëve z. Mehmet Elezi, ambasador i Shqipërisë në Bernë, z. Xhafer Ahmeti, konzull i Republikës së Kosovës në Bernë, etj.

Me këtë rast Z. Francis Cousin, bëri të njohura disa nga aktivitetet kryesore që do të zhvillojë ISEAL gjatë këtij viti: nga qershori 2010, do të jetë publik siti në Internet i ISEAL-it në tri gjuhë fillimisht: shqip, gjermanisht dhe frëngjisht ([www.iseal.ch](http://www.iseal.ch)), më 12 nëntor do të organizohet një mbrëmje me rastin e hapjes së ISEAL-it, më 13 nëntor një Simpozium shkencor me Universitetin e Lozanës (në gjuhën gjermane, frëngje dhe shqipe), kurse në vjeshtë parashihet hapja e lokaleve ISEAL, në Lozanë.

Po me këtë rast z. Driton Kajtazi e paraqiti propozimin e Besnik Camajit për krijimin e «Shoqatës së Autorëve Shqiptarë në Zvicër».

Ing Mentor Ilazi dhe Ing Arafat Sahiti propozojnë themelimin e Shoqatës së Inxhinierëve dhe Arkitektëve shqiptarë në Zvicër.

Ndërsa Prof Astrit LEKA, propozon që shoqata e miqve të ISEAL-it të mbështesë ngritjen e bustit të Eugène Pittard, etnolog, mik i shqiptarëve në Tiranë.

Po në këtë takim aktori Zymer Lutfiu, i përcjellur me kitare nga Ilir Bytyqi, lexoi fragmente nga veprat e 12 krijuesve shqiptarë në Zvicër, anëtar të shoqatës së miqsisë të ISEAL-it. Përgatitja e gjatë dhe puna serioze për mëkëmbjen e këtij instituti, si dhe projektet e emrat eminente nga të gjitha fushat e shkencës, kulturës, arsimit e tjerë, janë edhe një garanci që japin për të shpresuar se më në fund në Zvicër do të kemi një subjekt shpresëdhënës që do të merrtet me çështjet qenësore me të cilat preokupohen shqiptarët, duke afirmuar njëherazi edhe vlerat tona të mirëfillta në nivelet më të larta të qarqeve të ndryshme zvicerane.

Rexhep Rifati



NGA TAKIMI NË BERNË, NË KËMBË DUKE PËRSHËNDETUR, FRANCIS COUSIN, KRYETAR I KËSHILLIT TË FONDACIONIT ISEAL, ISH AMBASADOR I ZVICRËS NË SHQIPËRI.